



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR
AUTORITETIN KOSOVAR TË KONKURRENCËS
PËR VITIN FINANCIAR TË PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

Prishtinë, maj 2019

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Emine Fazliu e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Shefkije Beka-Gërvalla (Udhëheqëse e ekipit) dhe Mexhit Ferati (Anëtar i ekipit), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Shkëlqim Xhema.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	10
4 Qeverisja e mirë.....	16
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	18
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	20
Shtojca II: Letërkonfirmimi.....	22

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2018, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 27/11/2018.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm


Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Më gjerësisht shih pjesën 2.1 të këtij raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2018

Kryetari i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të AKK-së gjatë procesit të auditimit.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës (më tutje AKK-së), nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar për çdo fushë të rishikimit.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar

Ne kemi audituar PFV-të e AKK-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV

Drejtori i Përgjithshëm i AKK-së dhe Zyrtari Kryesor Financiar është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i AKK-së është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të AKK-së.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

AKK-së i kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin përfundimtar të Prokurimit;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve; dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).

Në kontekst të PFV-ve dhe kërkesave tjera për raportim të jashtëm, ne nuk kemi identifikuar ndonjë parregullsi. Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, konsiderohet e plotë dhe e saktë në të gjitha aspektet materiale.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Nuk kemi rekomandime lidhur me PFV-të.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, burimet njerëzore si dhe pasuritë e detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Menaxhimi financiar dhe kontrolli efektiv në AKK kërkojnë procese të rishikimit dhe vendosjen e mekanizmave të cilët sigurojnë zbatimin e plotë të procedurave dhe proceseve të tjera të kontrollit. Testet kanë treguar se nevojiten përmirësime në protokollimin e faturave dhe raportim të obligimeve të papaguara.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Burimet e Fondeve:	332,409	267,074	261,409	224,087	179,476
Granti i Qeverisë -Buxheti	332,409	267,074	261,409	224,087	179,476

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 65,335€. Ky zvogëlim ishte rezultat i vendimeve të Qeverisë për kursime buxhetore.

Në vitin 2018, AKK ka shpenzuar 98% të buxhetit final ose 261,409€, me një përmirësim prej 6% krahasuar me vitin 2017. Realizimi i buxhetit ishte në nivel të kënaqshëm.

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	332,409	267,074	261,409	224,087	179,476
Pagat dhe Mëditjet	259,548	202,537	202,537	170,657	140,429
Mallrat dhe Shërbimet	59,861	59,861	57,763	43,511	38,596
Shërbimet komunale	13,000	4,676	1,109	9,919	451

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore përfshirë arsyet dhe ndikimin që kanë pasur janë dhënë si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 57,011€, me vendim të Qeverisë² për kursime buxhetore. Shpenzimet në këtë kategori ishin 100% e buxhetit;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime krahasuar me buxhetin fillestar nuk kishte ndryshime. Në këtë kategori shpenzimet ishin 96% e buxhetit; dhe
- Buxheti final për shërbimet komunale krahasuar me atë fillestar ishte zvogëluar për 8,324€ si rezultat i vendimit të Qeverisë për kursime buxhetore. Te kjo kategori, shpenzimi i buxhetit ishte vetëm 1,109€ apo 24%, për arsye se në këtë vit me përjashtim të telefonisë fikse të gjitha shpenzimet tjera i ka kryer MAP-i.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

² Vendimi i Qeverisë për kursime buxhetore i datës 19.10.2018 Nr.02/70 dhe datës 18.12.2018 me Nr. 07/80

3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga AKK për vitin 2018 ishin në vlerë 9,300€. Ato kanë të bëjnë me përqendrimet³ e lejuara. Në raport me vitin e kaluar kemi rritje të të hyrave për 3,100€.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	2018 Pranimet	2017 Pranimet	2016 Pranimet
Të hyrat	9,300	6,200	3,000
Totali	9,300	6,200	3,000

Të hyrat e arkëtuara nga AKK transferohen në Buxhetin e Kosovës (BK). Nga mostrat e testuara nuk kemi vërejtur ndonjë çështje për t'u raportuar.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte 202,537€, i cili ishte shpenzuar në tërësi (100%). Numri i aprovuar i stafit ishte 25, ndërsa numri aktual i të punësuarve ishte 22.

Lidhur me këtë, ne testuam pajtueshmërinë e listave të pagave me sistemin e pagave si dhe nga testimet tona nuk kemi identifikuar ndonjë çështje për t'u raportuar.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

³ **Nocioni i Përqendrimit:** Përqendrimi i ndërmarrjeve krijohet me vendosjen e kontrollit të përhershëm me të cilën fitohet, bashkimi i dy ose më shumë ndërmarrjeve të pavarura ose pjesëve të këtyre ndërmarrjeve dhe kontrolli i drejtpërdrejt apo i tërthortë ose ndikimin e pozitës dominuese të një apo më shumë ndërmarrjeve ose pjesëve të ndërmarrjeve. (Më gjerësisht shih ligjin për mbrojtjen e konkurrencës). Në kërkesën me shkrim nga pjesëmarrësit e përqendrimit, AKK jep vërtetim se përqendrimi është lejuar.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime përfshirë shërbimet komunale në vitin 2018 ishte 64,537€, ndërsa ishin shpenzuar 58,872€. Në këto kategori shpenzimet kanë të bëjnë me: furnizim me kompjuterë, shpenzimet e udhëtimit, shpenzime për telefoni mobile, shpenzime të mirëmbajtjes dhe shpenzime të tjera.

Nga testet tona, ne kemi identifikuar çështjen si në vijim

Çështja C1⁴- Mos protokollimi i faturave të pranuar

Gjetja Sipas rregullës financiare nr. 01/2013/MF - Shpenzimi i Parave Publike neni 24, të gjitha faturat duhet të pranohen/protokollohen dhe të evidentohen në librin e faturave, duke i zbatuar procedurat e kontrollit të brendshëm për qarkullim të dokumentacionit.

Sikurse në vitin e kaluar, faturat e pranuar nga OE nuk ishin protokolluar dhe nuk kishin datën e pranimit nga AKK. Në shtatë pagesa në vlerë totale prej 10,125€, ku përfshihen 16 fatura nuk ishin të protokolluara. Kjo njëherë ka shkaktuar edhe vonesë në pagesat e tyre. Mos protokollimi i faturave ishte për pagesat e moduleve të blerjeve (shpenzimeve që kalojnë përmes prokurimit), ndërsa për shpenzimet përmes modulit të aprovimit faturat janë protokolluar.

Kjo ka ndodh për arsye të kujdesit jo të duhur dhe mos procedimit të faturave në financa për pagesë nga zyrtari përgjegjës.

Rreziku Mos protokollimi i faturave rrit rrezikun e humbjes së faturave, mos raportim të drejt të faturave të papaguara si dhe vonesa në pagesë të tyre. Kjo mund të krijojë implikime buxhetore për periudhën vijuese.

Rekomandimi C1 Kryetari i AKK duhet të sigurojë se zbatohen të gjitha procedurat e kontrollit të brendshëm për qarkullim të dokumentacionit dhe se fatura të protokollohen në momentin e pranimit.

⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
 Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
 Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Vlera neto e pasurive të AKK-së e shpalosur në PFV ishte 17,641€, kjo vlerë përfshinë pasurinë jokapitale nën 1,000€, pasi që pasuria kapitale mbi 1,000€ ishte me vlerë zero (0), ndërsa vlera e stoqeve në fund të vitit ishte 100€.

Ne kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit dhe mënyra e mbajtjes së evidencave është në pajtueshmëri me kërkesat e rregullës financiare Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurive Jo Financiare në Organizatat Buxhetore, procesin e inventarizimit, zhvlerësimin dhe ekzistencën fizike të pasurive.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.3 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2018 ishte 2,890€. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2019. Arsyeja e mbetur e këtyre obligimeve është pranimi me vonesë i faturave.

Lidhur me testet tone ne kemi vërejtur si në vijim:

Çështja A1 - Dobësi në raportimin e obligimeve të papaguara

Gjetja Sipas nenit 5 të Rregullores financiare 02/2013 për Raportimin e obligimeve të papaguara të organizatave buxhetore, obligim i vonuar për pagesë i organizatës buxhetore konsiderohet fatura e cila nuk është paguar 30 ditë pas pranimi të faturës. Ndërsa, sipas nenit 6, raportet e obligimeve të papaguara të organizatave buxhetore duhet të dorëzohen në afat prej 15 ditë pas përfundimit të muajit, për gjendjen e muajit paraprak.

Raportimet mujore për obligimet e papaguara në AKK nuk ishin të rregullta. AKK kishte raportuar për obligimet e papaguara vetëm në fund të vitit. Po ashtu, tri fatura në total prej 2,238€ të paguara në prill 2018 i takojnë periudhës së dhjetorit të vitit 2017, dhe si të tilla nuk ishin raportuar në raportet e janarit, shkurtit dhe marsit të vitit 2018 si obligime të papaguara në MF.

Kjo kishte ndodhur pasi faturat ishin të pa protokolluara dhe se stafi ishte ngarkuar me detyra shtesë.

Rreziku Mos raportimi i saktë i obligimeve mujore rrit rrezikun që faturat të mos identifikohen dhe të mos paguhen me kohë. Njëherit vonesat në pagesa mund të rrit rrezikun e ndëshkimeve për AKK-në në të ardhmen.

Rekomandimi A1 Kryetari i AKK-së duhet të siguroj kontrollë shtesë në raportimin e obligimeve, ashtu që vlerat e sakta të raportohen për periudha kohore dhe të përcillen nga muaji në muaj derisa të paguhen ato.

4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontroleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmer veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjerë janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

AKK në përgjithësi ka kontrolle të mira në raport me obligimet ligjore të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli ka dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe proceseve të tjera të kontrollit.

Qeverisja në AKK në fushën e raportimit menaxherial dhe llogaridhënies, si dhe menaxhimin e rreziqut mbetet në situatë të njëjtë më vitin e kaluar. Edhe më tutje nuk ishte hartuar plani strategjik si dhe nuk ishte bërë monitorimin i rreziqeve të paktën në periudha tre mujore. Ndërsa sa i përket rekomandimeve, AKK ka zbatuar vetëm një nga tre rekomandimet e vitit të kaluar.

4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Në bazë të kërkesave të parapara me U.A. nr.23/2009 për Themelimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm, AKK nuk i plotëson kriteret për themelimin e NjAB-së. Për vitin 2018, NJQH nuk kishte kryer ndonjë auditim i brendshëm për AKK-në.

Ne inkurajojmë menaxhmentin që të bëjë një rishikim të nevojave për auditim të brendshëm dhe të konsiderojë mundësinë e arritjes së një marrëveshje me ndonjë organizatë tjetër të sektorit publik që të shfrytëzojë shërbimet e auditimit të brendshëm.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranimit i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Çështja B1 - Mungesa e planit strategjik dhe monitorimit të rreziqeve

Gjetja Procedurat e MFK-së, përcaktojnë që plani strategjik duhet të përfshijë çështjet, qëllimet dhe objektivat strategjike, të cilat i ofron mbështetje për procesin e planifikimit operativ dhe lehtësojnë monitorimin e progresit drejt rezultateve të dëshiruara. Ndërsa menaxhimi i rrezikut është proces i përgjithshëm i identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të rreziqeve dhe zbatimit të kontrolleve ndaj tyre.

AKK edhe në këtë vit nuk kishte hartuar planin strategjik, siç kërkohet me procedurat e MFK-së, përveç që objektivat strategjike për vitin 2018 ishin përcaktuar në Programin e Punës për vitin 2018.

Edhe pse AKK kishte përgatitur regjistrin e rreziqeve, si i tillë nuk menaxhohet në mënyrë sistematike sa i përket azhurnimit dhe monitorimit se si janë ndërmarrë veprime për të zbutur këto rreziqe.

AKK ishte në proces të hartimit Planit Strategjik gjatë kohës së auditimit (prill 2019).

Rreziku Mungesa e planit strategjik, pamundëson trajtimin e çështjeve të cilat janë të domosdoshme për përmirësimin e efikasitetit dhe monitorimin e progresit drejt arritjes së rezultateve të dëshiruara në periudha afatgjate, më tutje mungesa e azhurnimit të regjistrit të rreziqeve ndikon në zvogëlimin e cilësisë së shërbimit.

Rekomandimi B1 Kryetari AKK-së duhet të siguroj hartimin e planit strategjik/proces të dokumentuar dhe efektiv të mbikëqyrjes së objektivave të përcaktuara. Po ashtu të sigurojë azhurnim dhe monitorim të vazhdueshëm të rreziqeve dhe raportim tremujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë.

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2017 ka rezultuar me tri rekomandime. AKK-ja kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen të gjitha rekomandimet, mirëpo ky plan nuk është zbatuar në tërësi. Prej tri rekomandimeve të dhëna, një ishte zbatuar, një pjesërisht si dhe një kishte mbetur i pazbatuara.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë trajtuar ato, shih tabelën në vijim:

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	Menaxhimi i personelit	Kryetari i AKK duhet të siguroj se angazhimi i stafit me shërbime të veçanta bëhet duke i zhvilluar procedura e rekrutimi në mënyrë që procesi të jetë transparent dhe konkurrues.	AKK në vitin 2018 nuk ka angazhuar staf me shërbime të veçanta.	I zbatuar.
2	Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Kryetari i AKK duhet të sigurojë se zbatohen të gjitha procedurat e kontrollit të brendshëm për qarkullim të dokumentacionit dhe se faturat të protokollohen në momentin e pranimit.	Faturat që kalojnë përmes modulit të aprovimeve janë protokolluar. Ndërsa ato përmes modulit të blerjeve edhe më tutje mbesin të pa protokolluara.	Pjesërisht i zbatuar.
3	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Kryetari AKK-së duhet të siguroj hartimin e planit strategjik/proces të dokumentuar dhe efektiv të mbikëqyrjes së objektivave të përcaktuara. Po ashtu të sigurojë azhurnim dhe monitorim të vazhdueshëm të rreziqeve dhe raportim tremujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë.	Mbetet gjendje e njëjtë si në vitin e kaluar.	I përsëritur.
Nr	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018		
1	Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Kryetari i AKK duhet të sigurojë se zbatohen të gjitha procedurat e kontrollit të brendshëm për qarkullim të dokumentacionit dhe se fatura të protokollohen në momentin e pranimit.		
2	Obligimet e papaguara	Kryetari i AKK-së duhet të monitoroj dhe sigurojë që raportimet e obligimeve të papaguara të jenë të plota, të bëhen brenda afatit prej 15 ditëve si dhe pagesat të kryhen brenda afatit kohor prej 30 ditëve.		
3	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Kryetari AKK-së duhet të siguroj hartimin e planit strategjik/proces të dokumentuar dhe efektiv të mbikëqyrjes së objektivave të përcaktuara. Po ashtu të sigurojë azhurnim dhe monitorim të vazhdueshëm të rreziqeve dhe raportim tremujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë.		

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të

cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit


157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letërkonfirmimi



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës
Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2018 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem me të gjeturën dhe rekomandimin dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimit, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tij.

z. Valon Prestreshi

Kryetar i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës

Data: 13.MAJ.2019, Prishtinë,

